REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

# A K T N O R M A T I V

**Nr._______, datë __________**

**PËR**

**<u>NJË SHTESË NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006, "PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE", TË NDRYSHUAR</u>**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Në nenin 36/1, të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë, me këtë përmbajtje:

"Përjashtimisht parashikimeve të nenit 15, të këtij ligji, pagesat e kësteve të parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin kryhen pranë bankave të nivelit të dytë dhe Postës Shqiptare, sh.a., për llogari të administratës tatimore, për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2020 brenda datës 20 tetor 2020, ndërsa për tremujorin e tretë dhe të katërt të vitit 2020 brenda datës 20 dhjetor 2020.".

**Neni 2**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ